

U D H Ë Z I M
Nr. 35, datë 18.05.2001

**PËR ORARIN E PUNËS SË KOMISIONEVE TË ZONAVE ZGJEDHORE DHE
KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT**

Në mbështetje të nenit 18 pika 1 dhe 3 dhe të nenit 32 pika 7 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, Komsioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Komisionet e Zonave Zgjedhore funksionojnë si organe te përhershme edhe për periudhën kohore pasi ka mbaruar procesi zgjedhor.

Për këtë periudhë, anëtarët e KZZ-së paraqiten në punë një herë në muaj, ditën e shtunë të javës së dytë të çdo muaji, nga ora 8 00 deri 12 00. Për punën e kryer kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e komisionit përfitojnë një shpërblim. Masa e shpërblimit përcaktohet me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, në periudhën nga mbledhja e parë e krijimit të KZZ-ve deri më datën 23.6.2001, orari i punës së komisioneve të Zonës Zgjedhore të jetë nga ora 8 00 deri 12 00 dhe nga ora 16 00 deri 20 00, kurse për periudhën nga data 24.6.2001 deri në dorëzimin e tabelave të rezultateve në KQZ, orari i punës së Komisioneve të Zonës Zgjedhore të jetë nga ora 6 00 deri 24 00.

3. Kur në Zonat Zgjedhore ka raund të dytë zgjedhjesh, për periudhën nga data 27.6.2001 deri më datë 7.7.2001, orari i punës së Komisioneve të Zonave Zgjedhore të jetë sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të këtij udhëzimi, kurse më datën 8.7.2001 e deri në dorëzimin e tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit në KQZ, orari i punës së Komisioneve të Zonave Zgjedhore të jetë nga ora 6 00 deri 24 00.

4. Gjatë periudhës së kohës nga mbledhja e parë e Komsionit të Zonave Zgjedhore e deri në dorëzimin e tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit në KQZ, përfshi këtu edhe periudhën kohore të votimit për raundit e dytë të zgjedhjeve në ato zona ku do të ketë të tilla, kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e komisionit i shkëpusin përkohësisht marrëdhëniet e punës që kanë me punëdhënësit me kohë të plotë pune dhe punojnë në zyrën e caktuar për KZZ.

5. Kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të KZZ-së, për periudhën që janë në procesin zgjedhor, u ruhet vendi i punës dhe marrëdhëniet financiare të vazhdojnë rregullisht si më parë, pranë punëdhënësve të tyre.

6. Anëtarët e KZZ-ve, për periudhën që punojnë sipas kohës së punës të përcaktuar në këtë udhëzim, shpërblehen në përputhje me masën që caktohet me vendim të KQZ-së.

7. Orari i punës për Komisionet e Qendrave të Votimit, nga mbledhja e parë deri në datën 23.6.2001 të jetë fakultativ, në varësi të detyrave dhe udhëzimeve të dhëna nga KZZ-ja, nga kryetari apo zëvendëskryetari i KQV-së. Nga data 23.6.2001 deri më datën 24.6.2001 orari i punës të jetë nga ora 8 00 deri 12 00 dhe nga ora 16 00 deri në ora 20 00. Nga data 24.6.2001 deri më datën e dorëzimit me proceverbal të tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit në KZZ-në përkatëse, orari i punës të jetë nga ora 7 00 dhe vazhdon pa ndërprerje deri më datën 25.6.2001, ora 18 00.

8. Në rast balotazhi në zonën përkatëse, KQV-të vazhdojnë të funksionojnë me orarin e përmendur në pikën 7 të këtij vendimi për datat 7, 8 dhe 9 korrik 2001.

9. Për punën e kryer, kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e KQV-ve përfitojnë një shpërblim. Masa e shpërblimit përcaktohet me vendim të KQZ-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi